



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.10.2018, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Roland Xhelilaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Çaroshi – Këshilltare e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendin e ditës së punës të këtij komisioni është vetëm një çështje, projektligji “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat ministri për Financat dhe Ekonominë, zoti Arben Ahmetaj. Relator i komisionit për këtë projektligj është zoti Ervin Bushati.

Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit nga ana e ministrit, pastaj me relatorin e komisionit, për të vijuar me pyetje dhe diskutime dhe në fund me votimin e projektligjit, që është prezantuar nga Këshilli i Ministrave.

Para se të fillojmë me prezantimin nga ministri, dua t’ju bëj me dije se sot në mëngjes kam marrë një shkresë që titullohet “Ftesë për bashkëpunim”, dërguar nga Shoqata e Basteve Sportive, sipas së cilës tri shoqëri bastesh, të licencuara në këtë fushë dhe që kanë nën to edhe kompani të tjera bastesh, kërkojnë të bashkëpunojnë me ne për respektimin e plotë dhe të menjëhershëm të ligjit “Për lojërat e fatit” në kategorinë e basteve sportive, gjë që ka qenë detyrimi më ekskluziv i tyre që nga viti 2015 dhe që nuk ka ndodhur; së dyti, reduktimin me 50% të numrit të pikave sekondare brenda vitit 2019 dhe një reduktim konstant në vitet pasardhëse, gjë e cila që nga viti 2015 jo vetëm nuk ka qenë në këtë tren, përkundrazi, kanë shumëfishuar NIPT-e sekondare në kompani të tjera të palicencuara; zbatimin e distancave deri në 100 metra nga institucionet arsimore dhe fetare, një tjetër pikë që ka qenë në ligj në mënyrë të qartë që nga viti 2015 dhe që nuk është zbatuar prej tyre; heqjen e reklamave në medie, një tjetër pikë që ka qenë e ndaluar në ligj dhe që nuk është respektuar prej tyre që nga viti 2015; pastrimin e fasadave dhe vetratave të dyqaneve nga elementet e basteve sportive, një tjetër kufizim i vendosur në ligj që nga viti 2015 dhe që nuk është zbatuar prej tyre; zvogëlimin e përmasave të reklamave identifikuese të dyqaneve në një madhësi jo më shumë se 1,2 metra katrorë, një tjetër kufizim ky që ka qenë në ligj që nga viti 2015 dhe që nuk është zbatuar përsëri prej tyre; kalimin në SQMO (sistemin qendror të monitorimit online) brenda vitit, me qëllim monitorimin e xhiros dhe të të ardhurave nga organet shtetërore, një tjetër detyrim që ka qenë në ligj dhe është refuzuar të zbatohet prej tyre; kontributin për identifikimin dhe trajtimin e personave që kanë varësi nga bixhozi dhe

bashkëpunim të ngushtë me AMLF-në për të eliminuar praninë e tyre fizike në pikat e basteve, si një tjetër kufizim që ka qenë në ligj dhe nuk është zbatuar prej tyre, madje ky kontingjent lojtarësh ka qenë targeti i tyre gjatë gjithë periudhës nga viti 2015 deri tani. Në fund kërkojnë realizimin e një bashkëpunimi me instancat shtetërore, një studim kombëtar me efektet financiare dhe pasojat negative të pjesëmarrjes së shqiptarëve në bastet sportive, nga i cili do të dalin konkluzione më efikase për trajtimin institucional të këtij fenomeni. Për këtë pikë nuk kërkohet fare bashkëpunim, pasi konkluzionet janë shumë të qarta që nga viti 2015 e këtej.

Desha t’jua bëja me dije, meqenëse letra më është adresuar mua, si kryetar i Komisionit të Ekonomisë, dhe ka ardhur vetëm sot në mëngjes, pak para se të fillonte mbledhja e këtij komisioni.

Fillojmë me procedurën normale të mbledhjes.

Fjalën e ka ministri i Financave dhe Ekonomisë për të bërë prezantimin e projektligjit.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se tashmë është shumë i qartë, madje i shprehur edhe publikisht, qëndrimi i qeverisë në lidhje me mbylljen e kazinove elektronike më 31 dhjetor të vitit 2018 dhe avancimi i kësaj logjike të shprehur nga Kryeministri i Shqipërisë, me vullnet politik dhe tashmë të zyrtarizuar, për mbylljen e kazinove elektronike, basteve sportive, sallave të bingos, basteve me gara sportive, si dhe, në reflektim të mëtejshëm të kësaj logjike, edhe asaj që teknikisht i referohemi si lojërat elektronike të fatit në distancë, pra atyre online.

Për ta sqaruar opinionin publik, qeveria ka një pozicion tashmë të konsoliduar zyrtar të avancuar edhe me këtë komision, se më 31 dhjetor të vitit 2018 do të mbyllet kazinotë elektronike; do të mbyllet bastet sportive; do të mbyllet bastet për garat sportive dhe ato me kafshë; do të mbyllet sallat e bingove, si dhe lojërat elektronike të fatit në distancë, pra ato online.

E gjithë ajo bolori politike që është shpalosur nga opozita në mbrojtje të të gjithë atyre që kanë abuzuar me këtë sektor, se po mbyllet aty për t’i hapur këtu; po mbyllin këto që t’i japin monopol atij, asaj, këtyre, sot vërteton se janë vetëm bolori politike. Qeveria e ka shumë të qartë qëndrimin e saj: më 31 dhjetor të këtij viti do të mbyllet kategoritë të cilave iu referova.

Madje ditën e djeshme patëm edhe një takim me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe me referuesin e ligjit, në mënyrë që zyrtarisht qeveria të poziciononte

qëndrimin e saj final në lidhje me këtë iniciativë të qeverisë, të Kryeministrit. Pra, e gjithë kjo histori nuk ka nevojë për shumë fjalë. Kemi vendosur të paraqesim në parlament një ndryshim ligjor, i cili, dhe këtu do të konkludoj, mbyll kazinotë elektronike; mbyll bastet sportive; mbyll bastet sportive për garat e ndryshme dhe ato me kafshë; sallat e bingo, si dhe bastet ose lojërat e fatit online. Kjo sqaron njëherë e mirë pozicionin e maxhorancës, të qeverisë dhe të Kryeministrit për sa i përket iniciativës që ne kemi avancuar së fundmi.

Patjetër që ka një periudhë për ta përgatitur deri më 31 dhjetor, madje ka kaluar edhe një vendim qeverie, i cili pezullon Autoritetin e Monitorimit të Lojërave të Fatit deri në ristrukturimin e plotë të tij, i ka dhënë autorizimin ministrit të Financave, me urdhër, t'i tregojë Autoritetit të Monitorimit të Lojërave të Fatit se çfarë do të duhet të bëjë deri në periudhën kur ristrukturohet plotësisht. Detyrat e Autoritetit do të jenë: lufta kundër informalitetit, ndihma ndaj të gjitha kompanive që do të mbyllen, plotësimi i dosjeve për inventar, informacioni publik për procesin e mbylljes. Gjithashtu, do të ndërpriten të gjitha proceset për aplikim lejesh ose rinovim lejesh.

Në të njëjtën kohë, së bashku me komisionin dje, vendosëm të avancojmë edhe atë qëndrim që do ta themi specifikisht në ligj, se ndalohen reklamat audiovizive për bastet e të tjerë, që do ta lexojmë pak më vonë, publicitetin në medie të ndryshme për lojërat e fatit.

Në të njëjtën kohë, dua të sqaroj opinionin publik dhe të gjithë ata që kanë qejf bolorinë politike në lidhje me lojërat e fatit, se kemi shtuar pikën 2.2 vetëm për të sqaruar opinionin, sepse në teknikën e ligjit kemi qenë shumë të qartë. Pas datës 31 dhjetor 2018 asnjë shoqëri nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra fati sipas konceptit, funksionit të VLT-së, përveç rasteve që i parashikon ligji në kazinotë e resorteve me 5 yje. Pra, nuk ka as VLT. Dua ta sqaroj pse është vendosur kjo këtu. Kjo ka të bëjë me Lotarinë Kombëtare, e cila ka një vendim, sipas të cilit i lejohet në bazë të ligjit të dikurshëm para vitit 2013, që të vendoste VLT, apo lojëra fati poshtë e lart. Nuk ka më, zero. Kjo është shumë e qartë. Për ne, për mua personalisht, ka qenë shumë e qartë. Unë kam mbajtur qëndrim zyrtar edhe në takimet me përfaqësuesit e Lotarisë Kombëtare. Tani, së bashku me komisionin, po e materializojmë edhe në ligj që nuk ka VLT.

Dua të shpjegoj për qytetarët, se VLT-të janë një formë e sofistikuar e kazinosë elektronike. Edhe kjo ndalohet me ligj, pavarësisht se Lotaria Kombëtare mund të pretendojë se e paska marrë si të drejtë me ligj të veçantë para vitit 2013. Kjo besoj se sqaron një herë e mirë të gjithë situatën e lojërave të fatit. Unë jam i bindur, se ne kemi të gjithë qytetarët me vete.

Jam i bindur se për ata që për fat të keq, do të gjenden për një moment pa punë, ka mundësi që nëpërmjet trajnimeve që ofron Shërbimi Kombëtar i Punës, apo rikualifikimeve për shkak të aftësive që mund të kenë pasur, të reflektuara dhe të lidhura me punën që kanë bërë deri tani, t'u krijojnë mundësi.

Më duhet të them se gjithsesi, industria do të krijojë një diferencë për të ardhurat buxhetore në vitin tjetër, por kjo nuk ka asnjë rëndësi për ne. Po ju them këtë, edhe si ministër përgjegjës për të ardhurat.

Ne po sfidojmë administratën tatimore dhe doganore që të mbledhin ato para që vinin nga lojërat e fatit. Në terrenin ekonomik është sfidë për tatimet, për doganat, për ISSH-në dhe për mua personalisht, për të mbajtur atë trajektore të konsolidimit fiskal, uljes së borxhit, mbajtjes poshtë të deficitit. Do të vijmë dhe do ta diskutojmë këtu. Do të jetë një rekord i ulët: 1,9% në 25 vjet. Thënë këtë, kjo maxhorancë dhe kjo qeveri po e konsolidon qëndrimin e saj për sa u përket lojërave të fatit para publikut, se me vetveten e ka të konsoliduar.

Unë do të ndalem këtu. Besoj se mund të ketë pyetje, referime dhe opinione. Jemi në gatishmëri që ta përfundojmë sot të gjithë setin e ndryshimeve një herë e mirë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bushati, si relator i komisionit për këtë projektligj.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Në fund të vitit 2015, me nismë të qeverisë, parlamenti miratoi një ligj të ri për lojërat e fatit, i cili synonte reformimin e kuadrit ligjor në fushën e lojërave të fatit, rregullimin e kësaj industrie, duke përcaktuar rregulla të qarta për ushtrimin e këtij aktiviteti për mbrojtjen e qytetarëve, të lojtarëve, përcaktimin e kufizimeve të qarta për zhvillimin e aktivitetit, zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit dhe subjekteve të tjera, veprimtaria e të cilëve lidhet me lojërat e fatit, garantimin e shlyerjes së detyrimeve kundrejt institucioneve shtetërore nëpërmjet një garancie bankare, ngritjen e një sistemi qendror të monitorimit *online* të subjekteve të lojërave të fatit, si dhe krijimin e një skeme të re taksimi për subjektet e lojërave të fatit sipas kategorive përkatëse. Për aktorët e tregut, që duhet të përshtateshin me kushtet e reja që dilnin nga ky ligj, u la një dispozitë tranzitore prej 1 viti.

Në fund të vitit 2016, nëpërmjet ligjit nr. 140 u shfuqizua pika 1 dhe u amenduan pikat 2 dhe 3 të nenit 71, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave, që ishin evidentuar, në lidhje me përmbushjen e kërkesave të ligjit. Këto amendime konsistojnë në zgjatjen e

afatit kohor për vlefshmërinë e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së kategorive: kazino elektronike, bingo tradicionale, nga 31 dhjetori 2016, deri më 31 dhjetor 2018. Zgjatja e afatit ishte e nevojshme duke pasur parasysh dhe vonesat e hasura në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit.

Qëllimi i këtij projektligji të propozuar nga Këshilli i Ministrave është ndërprerja e ushtrimit të aktivitetit të kategorive të lojërave të fatit, basteve sportive dhe të basteve për garat në pistë, duke propozuar shtimin e një pike të re në nenin 72, për dispozitat kalimtare, e cila përcakton se kategoritë e sipërpërmendura do të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018.

Situata aktuale e lojërave të fatit në vendin tonë dhe në veçanti kategoritë e basteve sportive, tregon se ato janë kthyer në një formë popullore lehtësisht të arritshme dhe të preferuar për argëtim. Përhapja e kësaj industrie që në fillim të viteve '90 ka shkaktuar viktima numri i të cilave është rritur ndjeshëm nga viti në vit dhe në veçanti, për grupmoshat e adoleshentëve dhe të rinjve, duke e keqorientuar individin për sigurimin e jetës dhe nevojave të tij të përditshme përmes aktiviteteve joproduktive. Për vetë kushtet ekonomike të vendit tonë dhe ndikimin në nivelin e varfërisë, kjo ka ndikuar në mosangazhimin e brezit të ri në shfrytëzimin më të mirë të alternativave të punësimit në sektorin privat dhe në atë publik.

Gjithashtu, varësia nga lojërat e fatit është bërë jo pak herë, shkak i dramave sociale, si divorcet, dhuna në familje, rritja e kriminalitetit dhe konflikteve mes personave për shkak të borxheve, duke shënuar në jo pak raste vrasje dhe vetëvrasje.

Sipas raportit të KLSH-së mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2016 rezulton se subjektet private, që kanë shtuar edhe më shumë borxhet për periudhën janar 2016, janë edhe kompani apo biznese private, që operojnë në fushën e lojërave të fatit.

Në vitin 2017 referuar buletinit statistikor nr. 4 të KLSH-së, evidentohen shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit me një shumë të konsiderueshme financiare prej 50 294 500 lekësh. KLSH-ja ka konstatuar gjithashtu, se informaliteti në fushën e lojërave të fatit vazhdon të mbetet i lartë. Në të ardhmen KLSH ka vendosur të bëjë auditim performace për to. Të dhënat zyrtare nga institucionet e tatimeve dhe nga QKR-ja në vitin 2016 tregojnë se shqiptarët kanë lënë 15, 5 miliardë lekë në baste dhe në kazino. Kjo shifër është më e madhe se 1% e PBB-së. Këto para ushqejnë një industri vesi, që ka shkatërruar dhe vazhdon të shkatërrojë me mijëra

familje. Në vitet 2015-2016 taksat e mbledhura nga kompanitë e kumarit ranë me 16%, duke zbritur në 4,52 miliardë lekë.

Modeli i biznesit të kësaj kategorie loje nuk rezulton me vlerë të shtuar për shoqërinë, përkundrazi zgjerimi i këtij aktiviteti në treg sjell një rrezik potencial për varfërimin e ekonomisë familjare dhe krijimin e dramave sociale.

Ndryshimi i propozuar nëpërmjet këtij projektligji, është në linjë me vendimet e GJEDNJ-së në të cilat është sanksionuar se qeveritë kombëtare lejohen ta kufizojnë tregun e lojërave të fatit për arsye të interesit publik dhe për mbrojtjen e konsumatorit, një vendim i paprecedentë i Gjykatës Europiane në raport me tregun, por në të mirë të interesit publik dhe të mbrojtjes nga kërcënimi të vetë sigurisë kombëtare, kur vjen puna që këtë aktivitet e merr në dorë krimi i organizuar.

Gjithashtu, dispozitat e këtij projektligji janë në të njëjtën linjë me ndalimin ligjor të parashikuar për kazinotë elektronike dhe bingo tradicionale, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018.

Duke qenë se ndryshimi i propozuar përmbush objektivat sociale të shtetit shqiptar dhe duke vlerësuar se frenimi i këtij sektori të lojërave të fatit është një prioritet kombëtar me qëllim dekurajimin e aktivitetit të biznesit në industrinë e lojërave të fatit, ju ftoj ta mbështesim këtë nismë dhe u bëj thirrje organeve përgjegjëse që të marrin të gjitha masat për zbatimin e ligjit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Fillojmë me pyetjet.

Ka pyetje?

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit zoti Ministër për prezantimin e këtij projektligji, që pa diskutim gëzon mbështetjen e kësaj maxhorance dhe që jam e bindur që sot do ta votojë.

Unë kam dy pyetje për këtë vendim.

Marr shkas nga deklarata e kryetarit të komisionit për mosrespektimin e të gjitha detyrimeve ligjore që kanë pasur kompanitë e basteve apo të lojërave të fatit që prej vitit 2015. Domethënë, ishin një sërë kufizimesh që ligji i parashikonte dhe që kompanitë nuk i kanë respektuar. Çfarë është bërë në lidhje me këtë gjë? A janë marrë masa? Janë vendosur

penalitetë? A janë mbyllur kompani? Mua më duket shumë e rëndë që ligji të parashikojë kaq shumë kufizime dhe këto të mos jenë respektuar nga kompanitë e basteve.

“Fundi i marrëzisë” nënkuptonte që informaliteti apo shkelësit e ligjit të dilnin nga sistemi. Në qoftë se ne kemi miratuar një ligj në vitin 2015, që përsëri nuk është respektuar, atëherë çfarë kemi bërë? Dua të di diçka më shumë për këtë situatë. A janë marrë masa apo jo?

Së dyti, ne e diskutuam, por edhe ju dhe relatori e thatë, që, po të bëjmë bilancin total të këtij vendimi, absolutisht që ka përfitime. Mijëra familje, nëna, gra dhe fëmijë na falënderojnë për këtë vendim, sepse i kanë vuajtur mbi kurriz pasojat e kësaj marrëzie prej vitesh.

Ndërkohë, duhet të marrim në konsideratë që mbyllen disa biznese dhe 7900 vende pune. Thënë këtë, a keni një plan konkret për mënyrën si do të rikualifikohen këta njerëz që preken nga ky vendim? Ju e përmendët pak, por m’u duk sikur thatë që ata mund të shkojnë te Shërbimi i Punësimit për të rigjetur veten. Do të ketë një program të strukturuar se si do t’u vihet në ndihmë këtyre njerëzve, apo atyre do t’u vihet në dispozicion zyra e punës apo të konkurrojnë diku tjetër? Këto pyetje kisha?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Beteja që është bërë për formalizimin e lojërave të fatit ka të bëjë jo thjesht me “Fundin e marrëzisë”, siç ju iu referuat operacionit, por vazhdon vit pas viti, pavarësisht aksioneve, me punën e institucioneve përgjegjëse.

Unë po ju numëroj masat administrative me konfiskim të pajisjeve të lojërave të fatit në subjektet e palicensuara nga data 1 janar e vitit 2014 deri në datën 31. 08. 2018. Për sa u përket basteve sportive, në vitin 2014 janë marrë 432 masa administrative, në vitin 2015 janë marrë 361 masa, në vitin 2016 janë marrë 521 masa, në vitin 2017 janë marrë 404 masa dhe deri në fund të muajit gusht të vitit 2018 janë marrë 234 masa. Pra, në total janë marrë 1952 masa. Për sa i përket konfiskimeve të automatëve elektronikë, janë bërë 2120 konfiskime.

Ndërkohë, ka një histori të gjatë monitorimi. Unë e kam thënë edhe herën e kaluar që kanë qenë 40 kompani, të cilat paguanin 3,7 miliardë lekë, kurse sot janë 20 kompani dhe paguajnë 5,4 miliardë lekë. Duke përfshirë konsekuencat e të ardhurave që vijnë nga pagat apo të tjera, shkon në 7 miliardë. Ndërkohë, janë hequr licencat e tre kompanive (*Inter Bast*, *Top Bast* dhe *Xhoi Loto*), që praktikisht u është fshirë leja.

Po të shikosh numrat e formalizimit, ata kanë ardhur për shkak të punës administrative. Unë nuk po them që puna administrative ka qenë ekselentë. Do isha i padrejtë

ta thosha këtë gjë. Fakti që këto kompani kanë arritur të reklamojnë aktivitetin e tyre kundër ligjit në televizione kombëtare dhe në portale dinjitoze, tregon që ligji nuk është zbatuar në ekstremitetet e veta legjitime.

Për sa i përket pyetjes që dytë, që ka të bëjë me punësimin, patjetër që janë 7400 vende pune. Duke iu referuar fjalës sime, ju thatë se duket sikur ne do ta lëmë në mëshirën e fatit këtë kategori. Jo, ne jemi duke përgatitur dy fushata shumë të rëndësishme trajnimi për vitin tjetër. Njëra i referohet asaj që ne i referohemi teknikisht *soft skills*, pra, mënyrës si kërkohet punë, ku kërkohet punë, ndihmesa e paraqitjes në punë, e sjelljes në punë, e aftësive, të cilat e bëjnë qytetarin më të punësueshëm ose e orientojnë ku, si dhe çfarë të kërkojë. Këtu do të përfshihen 63 mijë qytetarë dhe qytetare.

Në të njëjtën kohë, deri më sot u janë bërë trajnime teknike dhe profesionale 10 mijë qytetarëve të papunë. Për vitin tjetër ne do të financojmë trajnime profesionale për 20 mijë qytetarë. Kjo do të thotë që do të ketë mundësi trajnimi edhe për pjesën që do të dalë e papunë nga mbyllja e basteve sportive, kazinove elektronike, sallave të bingo apo basteve online.

Ka shumë programe punësimi apo sociale, por unë jam i bindur që një pjesë e mirë e të punësuarve në këtë industri do të mund të gjejnë punë në zgjerimin ekonomik që po ndodh në shumë sektorë në Shqipëri. Për më tepër, një pjesë e tyre kanë aftësi të lidhura me operacione kompjuterike për të cilat tregu ka nevojë. Me pak axhustim të aftësive nëpërmjet trajnimeve që iu referova apo kualifikimeve, patjetër që bëhen të punësueshëm në sektorë të tjerë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka pyetje tjetër nga kolegët deputetë? Diskutime?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Doja të shtoja dy pika që për mendimin tim janë të rëndësishme.

Së pari, është efekti i varësisë që krijon bixhozi dhe, së dyti, është proporcioni që po merr në Shqipëri. Pse e adresojmë pikërisht sot? Ka studime të universitetit të Notinghamit dhe të Kembrixhit në bashkëpunim, që vërtetojnë se varësia nga bixhozi është njësoj si varësia nga drogat e tjera të forta. Janë parë raste, që në maj të vitit 2010, ku çlirohen në tru të njëjtat dopanima neurotrasmetuese që janë njësoj si nga përdorimi i drogës për ata që vuajnë nga varësia e luajtjes së bastit.

Së dyti, dua të sjell një shifër, në qoftë se sot në botë matet varësia sipas humbjeve që ka një lojtar për popullatë të rritur, në vend të parë, duke pasur parasysh të ardhurat për frymë, është Australia, e cila humbet 1 mijë dollarë për frymë, axhustuar për nivelin e jetesës, i cili është 12 herë më i ulët në Shqipëri se sa Australia, ne ia kalojmë me trefish Australisë. Pra, ka arritur në proporcione epidemike. Shqiptarët, në qoftë se do të kishin të ardhurat më të larta ose të axhustoheshin sipas të ardhurave të Australisë, që sot është vendi i parë në botë, do të harxhonin ose harxhojnë 3 herë më shumë se vendi i parë në botë. Kjo tregon qartësisht se ky është momenti për të ndërhyrë.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Për t'i lënë vend shqyrtimit nen për nen, dua të them vetëm dy fjalë në mbyllje të diskutimit në parim.

Së pari, nisma e sotme tregon edhe një herë tjetër vullnetin e qartë të qeverisë dhe Kryeministrit Rama për t'i shkuar deri në fund këtij problemi, që ka krijuar pasoja të rënda sociale për shtresa të ndryshme të popullsisë së vendit. Kolegu Bushati e tha pak më parë, shifrat e të ardhurave familjare, përgjithësisht të ardhurave familjare, që përfundojnë në industrinë e kumarit në këtë vend janë të trendit 4%-4,5% të prodhimit të përgjithshëm kombëtar. Shifra, të cilat ikin nga buxhetet familjare për t'u bërë pjesë e një sipërmarrjeje, që, më lejoni ta pohoj me gojën plotë, nga viti 2015 e këtej, ka marrë goditje të njëpasnjëshme nga autoritetet ligjzbatuese të shtetit, por në krahun tjetër ka shfrytëzuar deri në zhatje varësinë e individëve, përfshirë edhe ato të individëve të ndaluar me ligj për të hyrë në biznesin e lojërave të fatit për 3 vjet me radhë.

Thënë këtë, dua ta pohoj me forcë që ligji, i cili është sot në fuqi, ka pasur kufizime të qarta për secilin nga operatorët e licencuar në fushën e aktivitetit të lojërave të fatit. Në mënyrë konstante operatorët kanë refuzuar zbatimin e ligjit dhe janë kujtuar vetëm tani të kërkojnë ndërmjetësim për zbatimin e ligjit. Ligji nuk zbatohet as për qejf dhe as për hall, ligji thjesht zbatohet. Kush ka refuzuar zbatimin e ligjit do të përballlet me pasojën që do të burojë nga amendamentet që ne do të miratojmë tani në raport me aktivitetin e lojërave të fatit.

Së dyti kam dëgjuar çdolloj arsyetimesh, parashikimesh dhe paragjykimesh gjatë gjithë këtyre dy javëve. Kam dëgjuar kolegë deputetë që thonë nuk do ta bëjnë, nuk bëjnë dot, nuk kanë për ta votuar. Amendamentet që ne miratojmë sot në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave i japin fund përfundimisht aktivitetit të basteve në këtë vend, i japin fund

përfundimisht aktivitetit të lojërave elektronike në distancë, përfshirë edhe ato që konsiderohen lojëra elektronike fati në distancë, por edhe basteve *online*, i japin fund veprimtarisë së bingove, heqin edhe mundësinë e devijimit të aktivitetit tek VLT-ja.

Përfundimisht ia kemi dalë që, pas ditës së enjte, t'i japim fund këtij aktiviteti. Natyrisht, do të luftojmë më pas për zbatimin deri në fund të ligjit, veçanërisht fenomeneve që mund ta pasojnë atë dhe që, pa asnjë lloj diskutimi do të konsiderohen dhe do të goditen si veprimtari haptazi të paligjshme që shkon deri në ndëshkimin me burg.

Së fundi, dua të falënderoj, pa as më të voglin dyshim, Kryeministrin e vendit, Edi Ramën, për konsekuencën në raport me këtë aktivitet dhe me konsekuencën në raport me ligjin dhe zbatimin e tij! Pa asnjë lloj diskutimi, dua të falënderoj ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, që është këtu, për vendosmërinë dhe goditjen e këtij aktiviteti, natyrisht për të çuar përpara amendimet për të mbyllur përfundimisht çdo lloj hapësire! Mbi të gjitha, dua të falënderoj këta burra dhe gra që shikoni këtu, të cilët kanë qenë konsekuentë në qëndrimin e tyre kundër aktivitetit të lojërave të fatit dhe jo vetëm! Natyrisht, jashtë kësaj sale mund të duket e thjeshtë, që këtu 11 burra dhe gra ngrenë dorën dhe votojnë për mbylljen e këtij aktiviteti. Por, dua të më besoni se këta njerëz që janë këtu dhe të tjerë që nuk janë tani në këtë sallë, por do të jenë të enjten në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kanë provuar gjatë gjithë këtyre ditëve presionin maksimal kriminal të segmenteve të caktuara që administrojnë sot aktivitetin e lojërave të fatit. Ja ku janë, nuk u ndalën dhe sot meritojnë respekt për aktin dhe për votimin e tyre në sallën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, kam vetëm një moment, që duhet ta ndaj këtu me ju, natyrisht, pastaj edhe me seancën plenare, bëhet fjalë për barrën fiskale për lojërat e fatit që do të mbeten për shkak të licencave të tyre për të ushtruar, sipas parashikimeve që ligji ka në të ardhmen, pas datës 1 janar.

Kam bërë një analizë të disa prej modeleve fiskale në disa vende të Bashkimit Europian, me të cilat nuk na lidh as religjioni apo tendenca të tilla, por na lidh thjesht dhe vetëm përkatësia jonë si europinë.

Në Austri, barra fiskale shkon nga 35%-80% të të gjithë të ardhurave të realizuara nga lojërat e fatit. Në Danimarkë 45%-70% mbi të ardhurat bruto të lojërave, kazinotë *online* i kanë 20% të të ardhurave bruto nga lojërat. Në Greqi të ardhurat bruto nga lojërat shkonjë 20-33%, 2-5% e të ardhurave bruto nga lojërat shkojnë për bashkitë dhe taksë fikse për të ardhurat e korporatës deri në masën 20%. Hungaria 30% e të ardhurave bruto nga lojërat, Holanda 40%-85% të të ardhurave neto nga lojërat, Portugalia 30%-50% të të ardhurave

bruto nga lojërat, Spanja 20-61% të të ardhurave bruto nga lojërat, Britania e Madhe 2,5%-40% të të ardhurave bruto nga lojërat dhe Luksemburgu 10%-80% të të ardhurave bruto nga lojërat. Ka një kategori vendesh të tjera, që e kanë të shkruar që në krye të ligjeve apo të traktateve të tyre, që ky aktivitet është monopol i shtetit. Franca 12% për çdo herë kur fitimet janë më shumë se sa 1500 euro për lojtar, ndërkohë për aktivitetin e lojërave të fatit nuk ka tatim, për shkak se Franca e ka monopol të shtetit. Gjermania 80% e të ardhurave bruto nga lojërat shkojnë për shtetin, në landin respektiv kur organizohet kjo veprimtari. Italia ka vetëm 1% të të ardhurave për shkak se edhe atje është monopol i shtetit. Në Suedi shteti ka monopolin mbi kazinotë dhe nuk ka taksë për fitimet. Ndërkohë, ka edhe një kategori të tjetër vendesh, me të cilat ne mund të ishim lehtësisht fare më afër, që janë vende të cilat kanë qenë në bllokun e famshëm të para viteve '90, bllokun komunist, Polonia takson me 45% të të ardhurave nga loja; Sllovakia takson me 27% të të ardhurave bruto nga loja; Sllovenia 18% të të ardhurave bruto nga loja, dhe Republika Çeke 20% të të ardhurave bruto nga loja. Të thëna të gjitha këto, unë gjykoj se barra fiskale që ne kemi për lojërat e fatit dhe kazinotë, që sipas ligjit duhet të mbeten në fuqi pas një viti, është e ulët. Për këtë do t'i drejtohem seancës plenare me një amendim lidhur me barrën fiskale. Kaq kisha, ju falënderoj për kontributin tuaj për t'i shkruar deri në fund këtij procesi.

Në radhë të parë kemi votimin në parim, pastaj kalojmë në votimin nen për nen.

Hedhim në votim projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Kalojmë te neni 1. Zoti Ministër dhe zoti Bushati kanë propozime.

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se do të ishte në përforcim të idesë, që e përkrahu edhe publiku, që në projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

Para nenit 1 shtohet dy nene me këtë përmbajtje: “Neni 1, “Organizimi i zhvillimit dhe ndërmjetësimi i lojërave të fatit, të basteve sportive dhe të lotarisë është përgjegjësi e shtetit”.

Neni 2 “Qëllimi”, shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje: “Ky ligj ka edhe këto objektiva: 1. Parandalimin e varësisë ndaj lojërave të fatit, basteve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për një lftutë efektive kundër kësaj varësie. 2. Kontrollin e kësaj varësie në kanale të kufizuara, të mbrojtura dhe të supervizuara të lojërave të fatit për të mos lejuar zhvillimin dhe përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme në tregun e zi. 3. Kundërveprimin për të siguruar të rinjtë dhe lojtarët. 4. Sigurimi që lojërat e fatit të kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe lojtarët të jenë të mbrojtur ndaj praktikave mashtruese, të cilat lidhen me krimin. 5. Të parandalojë kërcënimet për integritetin e konkurrencës sportive nëpërmjet verifikimit të veprimtarisë së fiksimit të rezultateve sportive. Për të arritur këto qëllime janë vënë në dispozicion masa të ndryshme kufizuese ndaj aktivitetit të lojërave të fatit, të varësisë, mashtrimit, manipulimit dhe kriminalitetit.”

Erion Braçe – A ka ndonjë opinion lidhur me propozimet e zotit Bushati?

Po, zoti Xhakolli!

Ilir Xhakolli – Meqenëse e dëgjova zotin Bushati kur foli për varësinë e lojtarëve të kumarit, ajo është e njëjtë edhe për ata që marrin drogë, për të cilët kemi marrë masat me qendra rehabilitimi, a është e mundur të ketë rehabilitim edhe për këta njerëz që janë në varësi të kumarit?

Erion Braçe – Zoti Xhakolli, ligji që është sot në fuqi ka masa korrektuese pikërisht për këtë gjë, duke adresuar fonde të posaçme në përqindje të caktuara edhe për këto aktivitete që ju po përmendni, duke përfshirë kulturën, sportin dhe natyrisht të shikojmë mundësinë me qeverinë për rehabilitimin dhe korrektimin e kësaj varësie te personat që janë dëmtuar nga ky aktivitet.

Ervin Bushati – Këto ndryshime që sillen janë aplikuar në shumë shtete dhe jemi bazuar në ligjet që adresojnë këto probleme, në Gjermani dhe në Francë. Kështu që mendoj se ka një logjikë, e cila vjen pas studimeve që janë bërë ndër vite dhe ndër afate më të gjata sesa eksperiencia shumë e shkurtër që kemi ne, për të kuptuar edhe pasojat e menjëhershme. Pra, vendet e tjera e kanë vuajtur me kohë, kanë marrë masa dhe patjetër që do të shikohet më vonë me legjislacionin sesi do të jetë në të gjitha aktet e tjera nënligjore, apo sipas fushave të ndryshme, si shëndetësia dhe arsimi.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka ndonjë gjë tjetër? Jo.

Atëherë, hedhim në votim propozimet e zotit Bushati, ku bëhet fjalë për dy ndryshime që bëhen në nenin 1 të ligjit bazë dhe në nenin 2 të ligjit bazë. Fillojmë me

ndryshimin e parë, para nenit 1 “Objekti” shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje: “Neni 1 “Përgjegjësia e shtetit”, “Organizimi i zhvillimit dhe ndërmjetësimi i lojërave të fatit, të basteve sportive dhe të lotarisë është përgjegjësi e shtetit”. Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi”.

Ervin Bushati – Pas nenit 2 “Qëllimi” shtohet neni 2/1 me përmbajtjen që lexova.

Erion Braçe – Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Vijojmë me nenin 1 të projektligjit.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Arben Ahmetaj – Për të konsoliduar propozimet, në nenin 1 do të shtojmë pikat 6 dhe 7 të nenit 9 “Publiciteti i lojërave të fatit”, dhe ndryshon si më poshtë vijon:

Pika 6, “Reklamat audiovizive për bastet sportive mund të bëhen vetëm gjatë transmetimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare”.

Pika 7, “Ndalohet publiciteti në mediat e shkruara në shtypin sportiv dhe në faqet sportive të mediave të tjera. Buletinet informative të organizatorëve nuk përbëjnë publicitet”.

Pra, pavarësisht se ne i kemi ndaluar ato kategori, përforcojmë edhe një herë elementin e publicitetit. Ky është neni 1 me ndryshimet.

Erion Braçe – A ka pyetje?

Po, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Ndoshta isha e pavëmendshme, por dua të di për sa u përket emisioneve sportive.

Arben Ahmetaj – Po, ndalohen. Reklamat audiovizive për bastet sportive mund të bëhen vetëm gjatë transmetimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Blerina Gjylameti – Nuk është aktivitet sportiv emisioni sportiv. Ndoshta duhet ta specifikojmë edhe këtë që të mos lejmë hapësira për abuzim.

Arben Ahmetaj – Ka qenë i ndaluar, tani shtojmë edhe ndeshjet.

Blerina Gjylameti – Dakord, faleminderit!

Erion Braçe – Që të jemi të qartë, ministri thotë që në ligjin ekzistues ka qenë e ndaluar që reklamat të publikohen gjatë emisioneve sportive e të tjera me radhë, por nuk është zbatuar. Gjatë transmetimit të ndeshjeve, reklama ka qenë e lejuar në ligj, ndërsa tani ndalohet edhe për to.

Hedhim në votim ndryshimin e propozuar nga ministri. Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Mund të vazhdoni, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Neni 2, në nenin 71 “Dispozitat kalimtare” bëhen këto shtesa dhe ndryshime. Ne do t’ua vëmë në dispozicion të shkruara ndryshimet. Në pikën 2, shtohet pika 2/1 dhe pika 2/2 me përmbajtje si më poshtë:

Pika 2/1: “Organizatorët e kategorive, të basteve sportive, basteve për garat në pistë dhe lojërat elektronike në distancë, sallat e bingove, nga shoqëri vendase apo të huaja, do të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018. Ndalohen të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë të kategorive të sipërpërmendura. Të gjitha aplikimet në proces shqyrtimi ndërpriten.”

Pika 2/2: “Mbas datës 31 dhjetor 2018, asnjë shoqëri, përfshirë edhe Lotarinë Kombëtare, nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra fati sipas konceptit/funksionit të VLT-së,- dhe këtë duhet ta definojmë,- përveç kategorive kazino dhe kazino-resort, që janë kategori të tjera...”

Erion Braçe – Të përcaktuara me ligj.

Arben Ahmetaj - Pika 2. Në pikën 3 hiqet togfjalëshi “basteve sportive dhe baste për garat në pistë”, si dhe togfjalëshi “të kategorive” zëvendësohet me “e kategorisë”, sepse mbetet vetëm një kategori. Kjo është arsyeja. Pra, është një rregullim teknik.

Erion Braçe – Faleminderit!

Zonja Gjylameti...

Blerina Gjylameti – Zoti Ministër, nuk dëgjova kazinotë elektronike.

Erion Braçe – Janë lojërat elektronike në distancë. Emërtimi është “lojëra elektronike në distancë”.

Blerina Gjylameti - Kazinotë elektronike nuk janë në distancë.

Edhe këto u referohen prapë atyre resorteve?

Arben Ahmetaj – I kemi vendosur një herë kazinotë elektronike. Tani po u shtojmë kazinove elektronike edhe bastet sportive, bastet për garat, *online*-in, që *kancelohet* dhe në 1 janar nuk ka më, si dhe sallat e bingove. Pra, kemi kazinotë elektronike, që kanë qenë më parë në ligj dhe po shtohen bastet sportive, bastet për gara, sallat e bingove dhe lojërat elektronike në distancë, që i referohet si definicion *online*-i, si dhe VLT-të, duke përfshirë edhe Lotarinë Kombëtare.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se jemi shumë të qartë nga...

Blerina Gjylameti – Po, faleminderit!

Erion Braçe – Atëherë, përpara se ta votojmë, mbyllet gjithçka. Pretendimi se po bëjmë rishpërndarje të këtij aktiviteti tek të tjerë njerëz, natyrisht, bie që nga ky moment. Po mbyllem gjithçka, duke përfshirë kazinotë elektronike, që kanë qenë në ligjin ekzistues dhe kanë pasur afat 31 dhjetorin e këtij viti, bastet, sallat e bingove, bastet *online* dhe çdo gjë tjetër.

E hedhim në votim propozimin e bërë nga ministri.

Kush është kundër? Nuk ka kundër. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni i fundit është hyrja në fuqi e këtij projektligji.

Keni ndonjë gjë tjetër, zoti Ministër? Kaq ishte?

Arben Ahmetaj - Nuk besoj se kemi gjë tjetër, por nëse ka ndonjë shtesë...

Erion Braçe – Dakord.

Hyrja në fuqi e projektligjit. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Mos duhet të themi “në datën 1 janar”?

Arben Ahmetaj - Të bëjë një sqarim nga teknika juridike?

Ligji mund të hyjë në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare, por efektet e *kancelimit*...

Erion Braçe – I shtrin që nga data 1 janar.

Arben Ahmetaj – Pse? Sepse kemi edhe elemente publiciteti, të cilat hyjnë në fuqi menjëherë.

Erion Braçe – Dakord. Unë besoj se....

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Zgjidhja është juridike, por duke shfrytëzuar edhe vullnetin e Presidentit të Republikës, ligji mund të hyjë në fuqi menjëherë. Edhe më herët, Presidenti i Republikës është shprehur kundër këtij aktiviteti. Kështu që mund ta shfrytëzojmë këtë. Kuvendi të ndjekë procedurat, në rast se do të marrë miratimin deri ditën e enjte. Mund të bëhet edhe ky ndryshim, që ky ligj të hyjë menjëherë në fuqi.

Votojmë edhe për këtë pikë.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë në tërësi projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar””.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit shumë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA